

Shoqëria civile e Lipjanit del me raportin monitorues për punën e ekzekutivit

YAHR-ja nxjerr në pah ngecje në përmbushje premtimesh

“Nga 22 premtimet e dhëna gjatë fushatës nga kreu komunal gjysma e tyre janë pa asnjë përpjekje apo angazhim konkret drejt realizimit, përderisa 10 premtime kanë shenja pozitive në realizimin e tyre. Deri tashti nuk kemi asnjë premtim të realizuar plotësisht”, ka thënë Krasniqi, udhëheqës në YAHR

KOHA
Ditore

ARIAN DURIQI

LIPJAN, 15 MAJ – OJQR (YAHR) në Lipjan ka dalë me raportin monitorues për punën e ekzekutivit të kësaj komune në këtë mandat, derisa ka konstatuar ngecje në përmbushje premtimesh elektorale që janë dhënë gjatë fushatës së fundit për zgjedhjet lokale më 2009. “Nga 22 premtimet e dhëna gjatë fushatës nga kreu komunal, gjysma e tyre janë pa asnjë përpjekje apo angazhim konkret drejt realizimit, përderisa 10 premtime kanë shenja pozitive në realizimin e tyre. Deri tashti nuk kemi asnjë premtim të realizuar plotësisht”, ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR. Për më tepër, Krasniqi ka theksuar se gjatë hartimit të raportit të tretë të organizatës që drejton punën e ekzekutivit është mbështetur në shumë burime të informacionit dhe në vetë monitorimin e Komunës në të gjitha fushat. “Qëllimi i monitorimit është të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike, por edhe të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur. Ndaj ne si shoqëri civile kemi monitoruar premtimet e kryetarit aktual Shukri Buja të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën tetor – nëntor 2009 dhe si rezultat i monitorimit del se gjysma e premtimeve nuk kanë nisur të jetësohen”, ka thënë ai. Krasniqi ndërkohë ndër problemet kryesore që sot e preokupojnë Komunën e Lipjanit ka thënë se janë mungesa e ngrohjes së qytetit, mungesa e një parku dhe hapësirave gjelbëruese, kundërmimi nga ferma e pulave dhe mungesa e përkujdesjes ndaj vendeve turistike dhe historike që ka kjo komunë. Ai ka në hartim të



Hasan Luma, shef i ZIP-it të Lipjanit, thotë se është ende herët të flitet për suksesin apo jo të procesit në përmbushje premtimesh nga pushteti lokal

raportit ka edhe rekomandime për pushtetin lokal. “Si rekomandim që është vënë në krye të listës është një angazhim më i madh i kryetarit Buja në përmbushje premtimesh. Po ashtu nevojitet një menaxhim më i mirë dhe transparenca më e madhe në shpenzimin e fondeve publike, sikurse edhe duhet të merren parasysh propozimet e qytetarëve për investimet kapitale sipas mundësive buxhetore”, ka thënë ai, ndërsa ka kërkuar po ashtu rifreskim të kabinetit të qeverisë lokale me persona më energjikë në disa drejtori në pjesën e dytë të mandatit. Nga ana tjetër, për të gjitha këto që janë thënë e shkruar në raportin e organizatës joqeveritare YAHR, Hasan Luma, shef i zyrës së

informacionit publik në Lipjan, thotë se është ende herët të flitet për suksesin apo jo të procesit në përmbushje premtimesh nga pushteti lokal i kësaj komune, pasi që, sipas tij, autoritetet komunale ende nuk janë në gjysmë të mandatit, derisa, siç thotë ai, është punuar mjaft shumë. “Aktualisht në Lipjan po zhvillohen punë të mëdha, që e dëshmon këtë edhe realiteti në terren. Nuk e di në çfarë baze është ndërton raportin, por mund të them se në përfundim të këtij mandati do të ketë rekapitullim të gjendjes dhe punës që është bërë dhe se do të ketë pasqyrë reale për atë që është punuar. Tash për tash mendoj se është herët të flitet për premtimet, sepse jemi afër gjysmës së mandatit”, ka thënë ai.

Partitë pjesëmarrës


punën e K

“KK-ja në vazhdimësi interes të qytetarëve dhe funksionin që ka”, t (LDD) thotë se këto vler

KOHA
Ditore

IBRAHIM SEFEDI

VITI, 15 MAJ – Grupimet më të mëdha të këshilltarëve të KK Vitisë: PDK- AAK si pozitë dhe LDD si opozitë, kanë vlerësime kundërta rreth punës së bashme të KK-së. Pozita thirret KK-ja, në tërësi, ka zbatuar agjendën e paraparë për punën opozita shprehet se KK-ja deri tashti ka vepruar me një agjendë inerte ndaj qytetarëve. Besim Halimi, nga grupi i këshilltarëve PDK-së, ka thënë se mbajtja e seancave të rregullta dhe miratimi i një numri të madh vendimesh rregulloresh, përfshirë këtu edhe vendimin për ndryshimin e Statutit të Komunës dhe atë për Planin zhvillimor komunal dhe urban, tregon se kjo përbërje e KK-së është në nivel të asaj për çfarë është thirrur. “KK-ja në vazhdimësi ka trajtuar çështjet që janë në interes të qytetarëve dhe si i tillë me sukses është duke kryer funksionin që ka ka thënë Halimi. E Reshat Aziz nga grupimi i këshilltarëve të AAK-së, ka thënë se KK-ja si institucion ku përfaqësohet pozita dhe opozita i ka dhënë një hapësirë të konsiderueshme opozitës duke mundësuar asaj që të gjitha çështjet që janë në interes të vendosë agjendën e KK-së. “Këshilltarët në



Zyrtarët përgjegjës komunalë alarmojnë për ndotje enorme të ujërave të lumit

“Silcapori” e ka rritur nivelin e ndotjes së Lepe

Deri tashti MMPH-ja nuk e ka marrë mundin për ta hequr nga agjenda këtë problem të madh